

351.74:006]:343.352

M-r Amir Dalipi<sup>1</sup>  
Doc. d-r Naser Etemi<sup>2</sup>

**ZBATIMI I PROGRAMIT ANTIKORRUPSION NGA SEKTORI I  
KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE STANDARDEVE  
PROFESIONALE**

**ПРИМЕНА НА АНТИКОРУПЦИСКА ПРОГРАМА НА  
СЕКТОРОТ ЗА ВНАТРЕШНА КОНТРОЛА И  
ПРОФЕСИОНАЛНИ СТАНДАРДИ**

**APPLICATION OF ANTICORRUPTION PROGRAM BY SECTOR  
FOR INTERNAL CONTROL AND PROFESSIONAL  
STANDARDS**

**Abstract**

Corruption is a social phenomenon that does not leave any sphere of life without infecting. It is present in public and in private life and mostly is present in the police. In the democratic developed societies especially low level corruption almost does not exist, while in Republic of Macedonia according to the data from the Ministry of Interior the corruption in the police is not reduced but it is growing. In this regard, various attempts are trying to improve this situation, various state bodies and other stakeholders trying to pass laws, programs or various acts with the aim to reduced this phenomenon. One of the strategic priorities of the Ministry of Interior, respectively of the Sector for

---

<sup>1</sup> Inspektor kryesor, Njësia për kontroll të brendshëm, hetime kriminalistike dhe standard profesionale, Ministria e punëve të brendshme, Republika e Maqedonisë.  
E-mail: [amir\\_dalipi\\_78@hotmail.com](mailto:amir_dalipi_78@hotmail.com)

<sup>2</sup> Docent në Fakultetin për detektiv dhe siguri, Universiteti i parë privat FON – Shkup, Republika e Maqedonisë. E-mail: [naseretemi@yahoo.com](mailto:naseretemi@yahoo.com)

Internal Control and Professional Standards is the fight against corruption and corrupt behavior among employees in departments and various sectors of Ministry of Interior, because it is a prerequisite for restoring confidence among citizens, the validity of the rule of law equally for all.

**Key words:** corruption, program, standard, control, measures

## 1. Vërejtje hyrëse

Programi “Antikorrupsion” ka për qëllim të përqendrohet në mënyrë aktive në luftën kundër korrupsionit e veçanërisht në Ministrinë e punëve të brendshme, që të krijojë një sistem riedukimi që mundësitë për sjellje korruptive të jenë në nivelin që mund të monitorohet në mënyrë të përhershme e kontrolluar dhe e sanksionuar në të gjitha rastet e përcaktuara të korrupsionit.<sup>3</sup>

Kuptimi i termit “Korrupsion” në polici është shkelje e procedurave, standardeve dhe mënyrën e të vepruarit të punonjësve në MPB, për të premtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ofruar, dhënë, kërkuar, pranuar përfitim material ose interes tjetër nga i punësuar në MPB, për veten apo për dikë tjetër.<sup>4</sup>

Korrupsioni në kohën e sotme ka marrë masa të tejkalueshme, pra është në çdo vend në shoqëri, kuptohet edhe në institucione (si MPB dhe institucione tjera), prandaj Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale (në vijim: KBSP) luan një rol të veçantë për ndalimin e korrupsionit që kërkon mjete dhe pajisje të nevojshme që pjesëtarët e SKBSP të luftojnë korrupsionin në radhët e policisë, kurse si akte të korrupsionit do të konsiderohet secili shërbim i kryer jashtë standardeve dhe afateve kohore të përcaktuara me ligj të kryera në mënyrë që të përfitojë përfitim personal.

Si sfera më të rrezikshme ku është përhapur korrupsioni dallohen vendet e punës edhe atë në policinë rrugore, policinë kufitare, administratën civile, por edhe te shërbimet të cilat drejtpërdrejtë punojnë me rastet, sikurse janë raste të krimit të organizuar dhe vendet e punës në MBP që kanë lidhje me tenderët (furnizimet) për nevojat e MPB (p.sh. derivatet për veturat zyrtare, pajisje me uniforma, etj.) prandaj është më

---

<sup>3</sup> Raporti vjetore “Programi Anti-korrupsion” Shkup, viti 2013, f.8.

<sup>4</sup> Shih Interpol, *Global Standards to Combat Corruption in Police Forces/Services* (shënimi 43), neni 2a; shih gjithashtu neni 2b.

shumë e nevojshme që të bëhet vlerësimi se a ekziston korrupsioni në secilin vend të punës.


Korrupsioni është një fenomen i rrezikshëm më shoqëri, sidomos kur haset brenda radhëve të policisë, të cilët duhet të jenë roje apo mbrojtës të ligjeve dhe normave ekzistuese në një shoqëri, pra nëse kemi polici të korruptuar, atëherë kuptohet se kemi rënie të besueshmërisë së publikut tek organet ligjzbatuese në veçanti, dhe i të gjithë sistemit që operon në vend, si dhe i hap më shumë rrugë kimit të organizuar dhe veprave të tjera penale, prandaj për të luftuar këtë plagë të shoqërisë është i nevojshëm përforcimi i ligjeve ekzistuese, adresimi i problemeve dhe mënyrës se si të zgjidhen problemet lidhur me korrupsionin si dhe rritja e transparencës dhe besueshmërisë nga ana e organeve që e zbatojnë ligjin dhe angazhim më me seriozitet nga shteti.<sup>5</sup>

Hulumtimi që është kryer në SPB-Tetovë (SP-Tetove dhe SP-Gostivar) vitin 2014 ku janë anketuar 105 pjesëtarë të policisë në lidhje me korrupsionin e kolegëve të tyre janë përgjigjur në vijim (kanë shënuar më shumë se një opsion) në tabelën e mëposhtme. Të anketuarit kanë pasur mundësi që të japin më shumë se një përgjigje në pyetjen e parashtruar.

*Arsyet pse pjesëtarët policor kyçen në aktivitete korrupsioni.*

	Nr	%
<b>Moskënaqja nga paga</b>	65	23,21%
<b>Pangopshmëria</b>	36	12,85%
<b>Kontrolli i pamjaftueshëm</b>	38	13,57%
<b>Shmangia e vlerave morale</b>	51	18,21%
<b>Ajo haset edhe në mjaft institucione tjera</b>	29	10,35%
<b>Ekziston tolerancë në Ministri drejt kësaj sjellje</b>	37	13,21%
<b>Ata nuk janë të vetëdijshëm se atë që e bëjnë është e gabueshme/e palejueshme</b>	24	8,57%
<b>Total:</b>	280	100%

<sup>5</sup> Gerard S., Pakoja e instrumenteve mbi integritetin e policisë,, DCAF-2012 f..227.



Nga të dhënat e tabelës së mësipërme shohim se si arsye kryesore për kyçjen e pjesëtarëve të policisë në korrupsion është moskënaqja nga paga edhe atë 23 % e të anketuarve (ose 65 polic), kurse sa i përket pangopshmërisë (36) 13 % janë të mendimit se është arsyeja kryesore për pjesëmarrjen e pjesëtarëve të policisë në korrupsion, të njëjtit mendim janë edhe për kontrollin e pamjaftueshëm 38 (14%), ndërsa te shmangia e vlerave të morale nga policët e anketuar 51 (18%) e vlerësojnë si një ndër arsyt kryesore për pjesëmarrjen e pjesëtarëve të policisë në korrupsion, të mendimit se korrupsioni haset edhe në institucionet tjera 29 (10%). Gjithashtu 37 (13) % të pjesëtarëve të policisë mendojnë se në MPB ekzistojnë tolerancë drejtë kësaj sjelljeje. Situata është alarmante në pyetjen se ata nuk janë të vetëdijshëm se atë që e bëjnë është e gabueshme apo e palejueshme ku 24 (8%) policë kanë dhënë mendimit e tyre.

### **Metodat për të luftuar korrupsioni në MPB**

Sipas organizatave ndërkombëtare metoda që mund të pranohen në luftën kundër korrupsionit klasifikohen në tre ndarje kryesore: ligjore, administrative dhe edukuese.

**Metoda ligjore** për të luftuar korrupsionin kanë për qëllim që autoritet në të gjitha nivelet të ofrojnë mekanizma ligjor dhe procedural ose sipas ligjeve të vendosura afatet dhe kufizimet kohore mbi aktivitetin e pjesëtarëve të policisë, për të siguruar sigurinë e duhur ligjore në pajtueshmëri me ligjet për të kontrolluar sjelljen korruptive në radhët e

policisë.<sup>6</sup> Ndëshkimi në rastet në fjalë të cilat vërehen nga udhëheqësit e strukturave policore duhet të jetë i drejtë ndaj të gjithë pjesëtarëve të policisë pa dallim grade dhe pozite të cilët në momentit e ushtrojnë pasi që në shumë raste ka lëshime për mosveprime të mëtutjeshëm, ndërsa masat kryesore për luftimin e korrupsionit janë:

- Masat afatshkurtra
- Masat afatmesme
- Masat afatgjata

Nevoja për ta adresuar korrupsionin si një pengesë për një polici profesionale dhe demokratike, një polici e aftë për t'u ballafaquar me detyrat dhe përgjegjësitë në kontrollin dhe sigurinë e qytetarëve është paraqitur si sfidë, për përpunimin e planeve të veprimit antikorrupsion dhe ngritjen e strukturave të specializuara antikorrupsion.<sup>7</sup>

Eksperiencia tregon se strategjitë e tilla kanë më shumë mundësi për të qenë të suksesshme nëse ato përmbajnë tre elemente, të cilët janë ngushtë të lidhur me njëri-tjetrin:

- Zbatimi i legjislacionit;
- Parandalimi;
- Ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e publikut në përpjekjet antikorrupsion.

*Masat afatshkurtra*

- Prezantimi i këtij problemi gjatë trajnimit;
- Shtimi i kontrollit për identifikimin e korrupsionit;
- Të vazhdohet me programin e trajnimit në shërbim;
- Përdorimi i metodave taktike siç është krijimi i vijës së dytë të kontrollit prapa pikave të kalimit kufitar;
  - Vendosija e mjeteve teknike: kamerat, mbikëqyrja në pikat e kalimit kufitar;
  - Të informohen qytetarët për instalim të linjës telefonike pa pagesë një telefon ku qytetarët mund të thërrasin lidhur me ndonjë informatë për denoncim të korrupsionit.

*Masat afatmesme*

---

<sup>6</sup> Klemancic G dhe Sustek J. "Institucionet Anti-Korrupsion" Rishkim i Modeleve OCED, 2007, gjetur në [www.oecd.org/dataoecd/7/4/39971957.pdf](http://www.oecd.org/dataoecd/7/4/39971957.pdf).

<sup>7</sup> Alan B., "Pakoja e instrumenteve mbi integritetin e policisë", DCAF-2012, f.291.

- Të ndërmerren veprime për t'i specializuar personat të cilët do ta luftojnë korrupsionin;
- Ngritja e të ardhurave personale të policisë kufitare në atë nivel ku humbja e punës për shkak të korrupsionit do të ishte një humbje e vërtetë;
- Ndryshimi i sjelljes përmes rritjes së zbulimit dhe ndëshkimit;
- Reduktimi i mundësive dhe mangësive organizative e funksionale, që të sigurohet se mjetet e informimit kanë liri për marrjen e të gjitha informatave në lidhje me korrupsionin, me përjashtim të përkufizimeve të domosdoshme për një shoqëri demokratike.
- Të sigurohet se ata të cilët e luftojnë korrupsionin të kenë një autonomi në funksionin e tyre, dhe të jenë të lirë nga ndikimi i jashtëm;
- Të sigurohet se organizata si dhe vendimmarrësit të jenë të vetëdijshëm se janë të obliguar ta luftojnë korrupsionin;
- Të sigurohet se është obligim i të gjithë të punësuarve të luftojnë korrupsionin dhe të veprohet me masa të nevojshme ndaj atyre të cilët nuk e luftojnë korrupsionin;
- Të sigurohet se është obligim ligjor lufta kundër korrupsionit.

*Masat afatgjata*

- Të forcohen kapacitetet institucionale për hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit;
  - Të zbatohet legjislacioni për parandalimin e mitmarrjes duke u mbështetur siç duhet në bashkërendimin ndërinstitutional;
  - Të shtypen broshurat të cilat janë të dedikuara për opinion (për qytetar) posaçërisht për denoncim të korrupsionit me numër të posaçëm të telefonit apo qendrave (përshkrimi i Rajoneve dhe Departamentit të Policisë ku munden të paraqiten);
  - Përpunimi i sistemit të vlerave dhe standardit të etikës;
  - Përforcimi i profesionalizmit të punonjësve.
  - Ndërmarrja e masave efektive për parandalimin e korrupsionit, dhe në këtë drejtim të punohet në ngritjen e vetëdijes të opinionit;
  - Krijimi i njësisë speciale antikorrupsion me fuqi të hetimit
- Lufta kundër korrupsionit kërkon zbatimin e politikave dhe të kodeve të sjelljes antikorrupsion në kryerjen e saktë të ndershme dhe të përshtatshme të detyrave policore, si dhe masa efektive për zbatimin e këtyre politikave në të gjitha nivelet e policisë.<sup>8</sup>

---

<sup>8</sup> Shih United Nations, *International Co-operation for Crime Prevention and Criminal Justice in the Context of Development* (1990), neni A.8; Hungarian

### **Metoda administrative për të luftuar korrupsionin në polici**

Metoda administrative ka të bëjë me procedurat e regrutimit që të sigurojë se të gjitha emërimet e personelit në polici duhet të jenë sipas kualifikimit dhe përshtatshmërisë (eksperiencë, personalitet) për një pozicion të caktuar e jo në bazë partiake, pasi që vlera e një kandidati për një pozicion të caktuar janë testet e aftësisë ku duhet të matin aftësinë fizike (p.sh. shpejtësia e reagimit), por edhe aftësinë mendore dhe psikologjike, ekzistimi i kriterëve të lartpërmendura për përcaktimin e emërimeve të pjesëtarëve në polici, minimizon paraqitjen e sjelljeve korruptive në strukturat policore.

Masë tjetër për parandalimin e korrupsionit në polici ka të bëjë me atë se si është niveli i pagës në krahasim me shoqërinë në përgjithësi, në qoftë se pagat e policisë janë shumë më të ulta se sa personeli i policisë kuptohet se kërkesat e policit për punë tjetër në sektorin privat është më se e nevojshme, prandaj punëdhënësi në këtë rast MPB duhet të monitorojë kushtet e punës dhe të zgjedh problemin me qëllim për mënjanimin e sjelljeve korruptive që paraqiten si autorë pjesëtarët e policisë.

Masa të mëtejshme administrative mund të përfshijnë shmangien e hapësirave për korrupsion duke ua hequr pjesëtarëve të policisë të drejtën për të marrë vendime të caktuara, ose duke i qarkulluar pjesëtarët e policisë rregullisht.<sup>9</sup>

### **Metoda e edukimit për të luftuar korrupsionin në radhët e policisë**

Të punësuarit në MBP kanë nevojë për trajnim që të informohen mbi atë se çka nuk është e pranueshme dhe çfarë ka ndryshuar.

Në MBP edukimi i pjesëtarëve të policisë zhvillohet me qëllim për rritjen e shkallës së informimit edhe pse në bazë të rekomandimeve nga Këshilli i Evropës më vitin 2001 është miratuara Kodi Evropian i etikës së policisë<sup>10</sup> me të cilin rregullohet sjellja e nëpunësve të policisë,

---

Helsinki Committee, *The Budapest Recommendations* (shënimi 32), neni 5;

<sup>9</sup> Shih Newburn, *Understanding and Preventing Police Corruption* (shënimi 48), f. 46.

<sup>10</sup> Committee of Ministers of the Council of Europe on 19.09.2001.

procesi i përzgjedhjes, trajnimi i pjesëtarëve të policisë, ndërsa në MPB të R. së Maqedonisë është miratuar më vitin 2007.<sup>11</sup>

Ky kod përcakton mënyrën e sjelljes, të punës dhe qëllimet e policisë, bazën ligjore e funksionimit të policisë, raporti i policisë dhe organet e jurisprudence, organizata e policisë, procesi i kualifikimit të përzgjedhjes, trajnimit të nëpunësve të policisë, të drejtat e pjesëtarëve të policisë, ndërhyrja e policisë, përgjegjësia nga kontrollat e policisë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar policor. Në këtë mënyrë në të vërtetë me miratimin e Kodin të etikës së policisë, fillon ndërtimi i një strukture tërësisht të re etike të pjesëtarët e policisë të pasuruar me vlerat e shoqërisë civile, në të cilin shërbimi policor ndaj qytetarëve do të jetë primar me përgjegjësi dhe transparent kështu që duke filluar nga parimet e përcaktuara të etikës dhe e sjelljes së policisë, të gjithë pa përjashtim funksioni që e ushtron në MPB, është i detyruar që të raportojë dhe të dëshmojë për të gjithë faktet dhe rrethanat që janë të njohura dhe janë të lidhura me një dyshim të caktuar të korrupsionit.

*Përcaktimi i natyrës dhe shtrirjes së korrupsionit brenda strukturave të policisë*

Duhet të identifikohet në kuadër të çdo regjioni se cilat struktura janë të prekura më së shumti nga korrupsioni;<sup>12</sup>

*Zbatimi i kodit të etikës dhe programi i masave për ndryshimin e gjendjes*

Të gjithë pjesëtarët e policisë duhet të njihen me kodin e etikës të policisë, rregulloret e brendshme dhe sjelljet e ndaluara të veprimit kundërligjor nuk do të ngelin pa u ndëshkuar;

*Implementimi i hapave disiplinore efektive*

Aplikimi i masave disiplinore është shumë i rëndësishëm, sepse nëse një shkelje korruptive nuk shoqërohet me mase disiplinore atëherë do të ketë shkelje të vazhdueshme dhe shkeljet do të përsëriten.<sup>13</sup> Është esenciale që masat disiplinore të zbatohen për të gjithë nivelet dhe në mënyrë të vazhdueshme dhe transparente të mos ketë diskriminim.

*Forcimi i strukturës kontrolluese*

Duhet të përpilohen plane të kontrollit dhe të raportohet mbi rezultatit e këtyre planeve me qëllim për tejkalimin e shkeljeve që

---

<sup>11</sup> Кодекс на полициска Етика (Сл.весник на РМ бр.72 од 11.06.2007 година)

<sup>12</sup> Анти-корупциска програма на СВКПС за 2014 година.

<sup>13</sup> Колективен договор на МВР (Сл.весник на РМ,бр.126 од 22.09.2010 година)



kryhen gjatë detyrës.

*Raportimi mbi rezultatin e aplikimit të strategjisë Antikorrupsion*

Do të jetë obligim i komandantëve të stacioneve që të raportojnë për çdo tre muaj mbi rezultatin e aplikimi të strategjisë Antikorrupsion.

### **Conclusion**

According to the members of the police the structure of the police who are mostly involved in corruption are traffic units, the border police, but this does not mean that other structure are not involved, some less and some much more. This clearly shows that even the police are paid to serv the citizens, they take money from citizens. Even if we take all measures and activities for preventing corruption, the results may not be quickly and immediate, because this phenomenon requires gradual an continous commitment, because the nature and character of corruption is such that it requires permanent and tireless struggle in order to achive its prevention and prohibition.

### **Literatura e shfrytëzuar**

- Alan B., “Pakoja e instrumenteve mbi integritetin e policisë” Qendra e Gjenevës për kontroll demokratik të forcave të armatosura DCAF, Gjenevë, 2012.

- Klemancic G dhe Sustek J., “Institucionet Anti-Korrupsion” Rishkim i Modeleve OCED, 2007, [www.oecd.org/dataoecd/7/4/39971957.pdf](http://www.oecd.org/dataoecd/7/4/39971957.pdf).

- United Nations, International Co-operation for Crime Prevention and Criminal Justice in the Context of Development (1990); Hungarian Helsinki Committee, The Budapest Recommendations (shënimi 32), neni 5;

- Кодекс на полициска Етика (Сл.весник на РМ бр.72 од 11.06.2007 год.)

- Анти-корупциска програма на СВКПС за 2014 год.

- Колективен договор на МВР (Сл.весник на РМ,бр.126 од 22.09.2010 год.)